

KOSOVO POLICE

# MBROJTËSI



PATRULLAT POLICORE  
TË ANGAZHUARA 24 ORË NË DETYRË



## EDITORIAL



**Baki KELANI**

**P**olicia e Kosovës, si institucion i zbatimit të ligjit, i mbajtjes së rendit dhe sigurisë publike, që nga fillimi i paraqitjes së rasteve të para me virusin COVID-19, ka qenë e angazhuar në menaxhimin e pandemisë së bashku me të gjitha institucionet e tjera.

Gjatë kësaj periudhe të menaxhimit me pandeminë, Policia e Kosovës ka qenë dhe mbetet e angazhuar në parandalimin e përhapjes së pandemisë, me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik si dhe të gjitha aktivitetet dhe masat e deritanishme i ka ndërmarrë në koordinim të plotë me të gjitha institucionet kompetente në fushën e shëndetësisë dhe institucioneve të tjera relevante, konform edhe angazhimeve dhe detyrave sipas planit për gatishmëri dhe reagim.

Punonjësit e Policisë së Kosovës në vazhdimësi gjatë kryerjes së detyrave kanë qenë të ekspozuar ndaj rrezikut për t'u infektuar me virusin COVID-19, por edhe përkundër kësaj me shumë nder kanë qenë në krye të detyrës dhe të përmbushjes së misionit të shenjtë në shërbim të qytetarëve të vendit.

Policia e Kosovës i kujton me krenari punonjësit e saj të cilët fatkeqësisht kanë humbur jetën nga virusi COVID-19. Puna e tyre mbetet shëmbëlltyrë për kolegët.

Policia e Kosovës i falënderon edhe qytetarët e vendit për bashkëpunimin, të cilët duke i respektuar udhëzimet e institucioneve shëndetësore po e bëjnë më të lehtë angazhimin e Policisë në terren. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar të punojë pa ndalur, duke bërë që qytetarët të ndihen të sigurt dhe të mbrojtur në çdo hapësirë ku jetojnë.



Revistë e Policisë së Kosovës

### Botues:

ZIMP  
Zyra për Informim dhe Marrëdhënie  
me Publikun e PK-së  
DPP - Prishtinë

### Kryeredaktor:

Baki KELANI

### Redaktor:

Daut HOXHA

### Menaxhimi i dizajnit dhe grafikes:

Çajup KAJTAZI

### Lektor:

Leonora FEJZULLAHU - RUHANI

### Fotograf:

Arbër MUHADRI

### Bashkëpunëtorë:

Baki KELANI  
Jeton REXHEPI  
Merita CANOLLI-GASHI  
Çajup KAJTAZI  
Arton ADEMI  
Mergim BEKTESHI

### Tel:

Tel.: 038 5080 1243  
Tel.: 038 5080 1237  
Mob.: 044 506 308  
Mob.: 044 181 418

### E-mail:

baki.kelani@kosovopolic.com  
daut.hoxha@kosovopolic.com  
zimp@kosovopolic.com

### Telefon: 192

info@kosovopolic.com  
www.kosovopolic.com  
facebook.com/KosovoPolice





# PËRMBAJTJA

**4|** Ministri Sveçla, gjatë takimit me drejtorin e Policisë, z. Mehmetin, ofroi mbështetje të plotë për Policinë

**5|** Partneriteti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ruhet dhe avancohet fuqishëm përmes bashkëpunimit reciprok, mbështetja amerikane për Policinë e Kosovës është e pazëvendësueshme

**5|** Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë z. Abbott dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Mehmeti, shprehin gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë

**6|** Gjermania i dhuron Policisë së Kosovës donacion mjaft të rëndësishëm

**6|** Koloneli Stefano FEDELE, komandant i MSU Carabinieri, me drejtorin e Policisë së Kosovës, z. Mehmeti, diskutuan çështjet e bashkëpunimit në aspektin e sigurisë

**6|** Znj. Kimberly Riffe, menaxhere e ICITAP-it për Kosovë, zhvilloi një takim me z. Samedin Mehmeti, i cili ishte i shoqëruar me bashkëpunëtorë

**7|** PARANDALIMI I DHUNËS NË FAMILJE, NË FOKUS TË TAKIMEVE DHE AKTIVITETEVE NDËRINSTITUCIONALE DHE PARTNERËVE TË TJERË

**8|** NË BALLË TË SFIDËS

**9|** Zyrtarët policorë që intervenuan në incidentin e zjarrit në një ndërtesë kolektive në Fushë Kosovë vizitohen nga drejtori i Policisë, në shenjë mbështetje dhe vlerësimi për punën e tyre në ndihmën ofruar qytetarëve

**10-11|** PATRULLAT POLICORE, TË ANGAZHUARA 24 ORË NË DETYRË

**12|** Nën moton “Duaje jetën - duaje veten”, Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicën e Jugut, zhvilloi aktivitet të veçantë

**14-15|** INFERMIERJA E POLICISË QË ME PUNË E POZITIVITET E PËRBALLON ÇDO VËSHTIRËSI

**16-17|** ROLI DHE ANGAZHIMI I DIVIZIONIT TË KOMUNIKACIONIT RRUGOR

**18|** Policia e Kosovës më afër qytetarëve edhe përmes internetit

**20-21|** KORONAVIRUSI DHE SHËNDETI MENDOR

**22-23|** Operacione

**24-25|** Struktura trikotome e kriminalistikës dhe profilizimi i Policisë në këtë segment

**26-27|** Kuriozitete

**28|** Duke nderuar zyrtarët tanë që kanë humbur jetën nga ‘Covid-19’

## PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të disa shkrimeve të këtij botimi nuk paraqesin medeomos qëndrimet ose vështrimet zyrtare të PK-së.





## Ministri Sveçla, gjatë takimit me drejtorin e Policisë, z. Mehmetin, ofroi mbështetje të plotë për Policinë

Vizita u realizua në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, me 29.03.2021, ku drejtori i Përgjithshëm i PK-së, së bashku me drejtuesit më të lartë të Policisë, priti në një takim ministrin me bashkëpunëtorët e tij.

Gjatë takimit z. Mehmeti, përmes një prezantimi të punës së Policisë së Kosovës, e njoftoi ministrin me angazhimet, rezultatet dhe aktivitetet policore në zbatim të objektivave strategjike dhe angazhimet konkrete në fusha të veçanta, përfshirë angazhimet në zbatim të vendimeve për parandalim të pandemisë.

Pjesë e prezantimit ishin edhe projektet e planifikuara, si: "Plani vjetor i punës", "Plani për fuqizimin e integritetit në Policinë e Kosovës 2021-2025", "Plani Strategjik Zhvillimor 2021-2025", "Strategjia e Integruar e Policimit të Drejtuar nga Intelejencia dhe Policimit në Bashkësi 2021-2025", "Projekti i vendosjes së kamerave në stacione policore" dhe kamerave që pritet në të ardhmen të vendosen tek zyrtarët policorë "(kamerat e trupit)".

Po ashtu u veçuan edhe projektet e vendosjes së GPS-ve në automjete, realizimi i projekteve mbi trajnimet shtesë në fusha të ndryshme, si: të komunikimit, sjelljes dhe disiplinës, integritetit dhe performancës, taktikave



mbrojtëse dhe përdorimit të forcës, ricertifikimit të zyrtarëve policorë, përfshirë edhe sfidat me të cilat ballafaqohet PK-ja.

Ministri i MPB-së, z. Sveçla, falënderoi Policinë për rezultatet e arritura, për punën dhe angazhimet në drejtim të ofrimit të rendit dhe sigurisë publike në vend, përfshirë angazhimet dhe masat policore që po ndërmerren në parandalimin e përhapjes së pandemisë,

me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik, ku PK-ja, së bashku me personelin mjekësor, janë në vijë të parë të frontit, andaj përkujtoi edhe zyrtarët policorë të rënë në kryerje të detyrës, përfshirë zyrtarët të cilët fatkeqësisht kanë humbur jetën nga pandemia COVID -19.

Ministri Sveçla siguroi Policinë e Kosovës se do ta përkrahë dhe do ta mbështesë në të gjitha format e mundshme, përfshirë përkrahjen në Ligjin për pensionim të parakohshëm, për sigurimin shëndetësor e çështje të tjera që janë në interes të PK-së.

Njëkohësisht kërkoi nga PK-ja që të ngrihet edhe më tej efikasiteti dhe efektiviteti në punë, performanca dhe integriteti policor, transparenca, përgjegjësia dhe llogaridhënia, rritja e bashkëpunimit me komunitetin si dhe lufta ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Menaxhmenti i Policisë së Kosovës u zotua se do të vazhdojë me angazhime konkrete në zbatim të ligjit, në ofrimin e sigurisë, ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike, parandalimin dhe luftimin ndaj çdo forme të krimit dhe korrupsionit. Ministri Sveçla me drejtorin e Përgjithshëm, z. Mehmetin, pas takimit vizituan edhe Drejtorinë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit, në kuadër të Policisë së Kosovës.





## **Partneriteti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ruhet dhe avancohet fuqishëm përmes bashkëpunimit reciprok, mbështetja amerikane për Policinë e Kosovës është e pazëvendësueshme**

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Samedin Mehmeti, ishte mikpritës i takimit me drejtorin e INL-së, z. Shawn Waddoups dhe atashen e DOJ-ICITAP, znj. Kimberly Riffe nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara. Qëllimi i takimit ishte dhurimi i pajisjeve mbrojtëse personale (PPE) për të ndihmuar në mbrojtjen e zyrtarëve të Policisë gjatë pandemisë dhe pajisjeve të teknologjisë së avancuar për luftimin e krimit në Kosovë.

Në lidhje me këtë, drejtori i Përgjithshëm i PK-së, z. Mehmeti falënderoi z. Waddoups dhe znj. Riffe dhe përmes tyre qytetarët e SHBA-së dhe taksapaguesit për këtë donacion, si dhe për mbështetjen e vazhdueshme që Policia e Kosovës merr nga Qeveria e SHBA-së. Gjithashtu, z. Mehmeti theksoi se pajisjet e dhuruara do ta lehtësojnë punën e zyrtarëve të Policisë në luftimin e krimit.

Drejtori i INL-së, z. Waddoups vlerësoi bashkëpunimin e vazhdueshëm që ata kanë me PK-në, ndërsa siguroi që mbështetja e tyre do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ai theksoi se nevojat e tjera për asistimin për Policinë e Kosovës do të identifikohen në të ardhmen, dhe në këtë mënyrë, ne do të ruajmë partneritetin në mes të dy palëve.



**Ambasadori i Britanisë së  
Madhe në Kosovë z. Abbott dhe  
drejtori i Përgjithshëm i Policisë  
së Kosovës, z. Mehmeti,  
shprehin gatishmërinë për  
vazhdimin e bashkëpunimit në  
fushën e sigurisë**



Gjatë një takimi mikpritës, të mbajtur në Drejtorinë e Përgjithshme të PK-së, me 1 mars 2021, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Samedin Mehmeti, i dëshiroi mirëseardhje ambasadorit britanez z. Nicholas Abbott dhe njëkohësisht e njoftoi të njëjtin me angazhimet policore në fushën e sigurisë dhe bashkëpunimit reciprok.

Ambasadori Abbott e falënderoi drejtorin e Përgjithshëm z. Mehmeti për punën e Policisë dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer që ata kanë në mes tyre dhe i uroi për pozitën e drejtorit të Përgjithshëm.

Takimi rezultoi edhe me gatishmërinë e vazhdimin të bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe mbështetjes në fusha specifike në mes të dy institucioneve.



## Gjermania i dhuron Policisë së Kosovës donacion mjaft të rëndësishëm



Policia e Kosovës ka pranuar në vazhdimësi donacione mjaft të rëndësishme me pajisje nga shteti gjerman.

Muajt e fundit Gjermania i ka dhuruar Policisë së Kosovës donacion në pajisje dhe vetura në vlerë mbi gjysmë milioni euro.

Me 14.01.2021, dorëzim-pranimi i donacionit me pajisje për Policinë u bë nga ambasadori gjerman në Prishtinë z. Joern Rohde dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Samedin Mehmeti.

Me rastin e pranimit të këtij donacioni drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Samedin Mehmeti, shprehu falenderimin e tij për popullin dhe shtetin gjerman në ndihmën e ofruar në vazhdimësi për Policinë e Kosovës. Policia e Kosovës është gjithmonë mirënjohëse për ndihmën e ofruar nga partnerët tanë dhe pajisjet e ofruara nga shteti gjerman do të përdoren në mënyrën më të mirë, tha ndër të tjera.

Ambasadori Joern Rohde me këtë rast tha: "Është një nder i veçantë të dorëzosh pajisje për Policinë e Kosovës, duke nënvizuar edhe më tej mbështetjen tonë gjermane për një kohë të gjatë për ndërtimin e kapaciteteve të Policisë së Kosovës."

Donacioni i dhuruar përfshin 16 pajisje të shikimit natën, 8 palë dylbi të imazhit termik, 3 detektorë, si dhe laptopë e pajisje trajnimi me vlerë prej më shumë se 240.000 EUR.



## Koloneli Stefano FEDELE, komandant i MSU Carabinieri, me drejtorin e Policisë së Kosovës, z. Mehmeti, diskutuan çështjet e bashkëpunimit në aspektin e sigurisë

Në takimin e realizuar në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës në Prishtinë, me 01.04.2021, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Samedin Mehmeti, i shprehu kënaqësinë kolonelit Stefano FEDELE, komandant i MSU Carabinieri, për nivelin e bashkëpunimit të deritashëm. Gjatë këtij takimi njoftues, përveç të tjerash, u diskutuan edhe tema të ndryshme që ndërlidhen me fushën e sigurisë si dhe u konfirmua vazhdimi i bashkëpunimit të ndërsjellë edhe më tej ndërmjet Policisë së Kosovës dhe MSU Carabinieri.

## Znj. Kimberly Riffe, menaxhere e ICITAP-it për Kosovë, zhvilloi një takim me z. Samedin Mehmeti, i cili ishte i shoqëruar me bashkëpunëtorë



Në ambientet e Administratës së PK-së, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Samedin Mehmeti, me bashkëpunëtorë, realizuan një takim mjaft të rëndësishëm, në të cilin ishte e pranishme edhe znj. Kimberly Riffe, menaxhere e ICITAP-it për Kosovë. Qëllimi i këtij takimi ishte organizimi i disa tryezave të rrumbullakëta, për të trajnuar zyrtarët e dhunës në familje, ku si ligjërues apo drejtues

do të jetë vetë znj. Kimberly. Përmes këtyre tryezave do të bashkëbisedohet lidhur me dhunën në familje dhe pranimin e sugjerimeve lidhur me formimin e një formulari/pyetësori për veprimet që duhet marrë në trajtimin e këtyre rasteve. Policia e Kosovës falënderon ICITAP-in amerikan për mbështetjen dhe përkrahjen e vazhdueshme në fusha të ndryshme.

## PARANDALIMI I DHUNËS NË FAMILJE, NË FOKUS TË TAKIMEVE DHE AKTIVITETEVE NDËRINSTITUCIONALE DHE PARTNERËVE TË TJERË

**Tryeza është mbajtur nën drejtimin e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, z. Samedin Mehmeti, i shoqëruar nga menaxhmenti i lartë, si dhe eprorë kompetentë nga Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim**



Duke iu referuar situatës me dhunën në familje, me datën 25.03.2021, në objektin e Administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, është mbajtur tryezë për këtë temë. Në fokus të tryezës ishte situata aktuale e dhunës në familje, roli i institucioneve në trajtimin e kësaj dukurie si dhe mënyrat dhe format e bashkëpunimit, bashkëveprimit dhe koordinimit të aktiviteteve me të gjithë aktet në përballje me këtë fenomen.

Tryeza është mbajtur nën drejtimin e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, z. Samedin Mehmeti, i shoqëruar nga menaxhmenti i lartë, si dhe eprorë kompetentë nga Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim.

Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin edhe përfaqësues të institucioneve vendore që merren direkt me rastet e dhunës në familje, si përfaqësues nga: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të

Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Prokuroria e Shtetit, Qendra për Punë Sociale, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave, përfaqësues të strehimoreve, përfaqësues nga Agjencia për Barazi Gjinore dhe pjesëmarrës nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare, si: Rrjeti i Grave të Kosovës, UNDP, UN Women, OSBE, ICITAP, përfaqësues të BE dhe EULEX-it.

Në këtë tryezë, drejtori i Përgjithshëm i PK-së, z. Mehmeti, bëri një rezymë në lidhje me dhunën në familje, obligimet dhe përgjegjësitë që ka Policia e Kosovës në trajtimin e kësaj dukurie si dhe planifikimet policore sa i përket dhunës në familje.

Ndërsa, nga kolonel Gazmend Hoxha është bërë një përshkrim i mënyrës së trajtimit të dhunës në familje nga Policia e Kosovës, si dhe nga përfaqësuesit e sektorit të dhunës në familje janë prezantuar statistikave të dhunës në

familje, si dhe aktivitetet sensibilizuese të planifikuara për realizim gjatë vitit 2021.

Në këtë tryezë po ashtu janë paraqitur këndvështrimet profesionale nga ana e aktërëve që ishin prezentë, për dhunën në familje dhe ngritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit të detyrave dhe aktiviteteve, për të luftuar dhe për të parandaluar dhunën në familje.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Samedin Mehmeti, u zotua para pjesëmarrësve se Policia e Kosovës do të vazhdojë trajtimin e rasteve të dhunës në familje me prioritet dhe profesionalizim të lartë dhe se të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e pranuar gjatë kësaj tryeze do të merren me seriozitet dhe do të shqyrtohen nga ana e menaxhmentit policor, sepse vetëm përmes koordinimit efikas të aktiviteteve mund të parandalohet kjo dukuri negative në shoqëri.



## NË BALLË TË SFIDËS

Puna është një aktivitet që kërkon disiplinë, përkushtim, kërkon edhe vlerësim, edhe përkrahje, kërkon përgjegjësi, kërkon shpesh edhe vetëmohim, puna është nder!

Me punën tënde ti bëhesh i pavarur, fiton siguri, vetëbesim, e zhvillon të komunikuarit me njerëzit dhe me punën tënde ti gjithnjë e ndihmon dikë...

Një ndër profesionet që përgjegjësi ka t'i ndihmojë njerëzit, duke u ofruar siguri, është puna e policit.

Një zyrtar policor është i përgatitur profesionalisht të jetë në ballë të sfidave, sido qofshin ato.

Përballjet me situatat e panjohura tashmë janë pjesë përcjellëse e rrugëtimit të tij profesional.

Ai është i thirrur për mbrojtje, për përballje, ai shfaq besueshmëri, është gjithnjë i gatshëm të përgjigjet, të rrezikojë, të monitorojë me detyrën që i jepet.

Zyrtari policor nuk është plotësisht i lirë nga detyra as kur është në gjumë, ai është gjithnjë i thirrur për të intervenuar. Ai është polic 24 orë.

Uniforma unike e policit, kudo që shihet, shfaq siguri për njerëzit.

Shpeshherë zyrtarët policorë hasin në situata që edhe jetën e tyre e vënë në rrezik, e prapë ata vazhdojnë punën, sepse duhet t'iu përgjigjen thirrjeve, të mbajnë përgjegjësi, të shfaqin siguri e të vendosin rregull përreth.

Ai punon në bazë të ligjeve dhe rregullave institucionale dhe i zbaton në përpikëri në punët e përditshme. Ligji është udhërrëfyes për punë.

Detyrat e një zyrtari policor janë të larmishme, por që të gjitha janë të rregulluara në mbrojtje të jetës, dinjitetit dhe pronës së qytetarit.

Polici shpesh përballet me një hajdut që mund të shkrepë pa ndalur, me disa protestues të dhunshëm, një të sëmurë



**Atë's'e lag shiu' e as 'nuk e mbulon bora', ai kryen detyrat në vendet ku është i caktuar, sepse është betuar për këtë**

që e sulmon, një që fyen, ndonjë që s'bindet, një tjetër që bën shaka, dikush që e përqesh e dikush që edhe e lëvdon dhe e përgëzon, mirëpo ai vazhdon ta bëjë punën e tij, të mbajë rend dhe me qetësi e durim, duke treguar profesionalizëm, t'i kalojë të gjitha këto situata.

Atë "s'e lag shiu" e as "nuk e mbulon bora", ai kryen detyrat në vendet ku

është i caktuar, sepse është betuar për këtë.

Ai ka edhe familje, të cilës nuk mund t'i përgjigjet siç e ka obligim, sepse detyrat policore janë ato që e bëjnë të jetë i ngarkuar.

Në bazë të rrethanave dhe ndodhive oraret shpeshherë janë të tejzgjatura dhe ngarkesat bëhen më të theksuara.

Uniforma bart përgjegjësi, por mban në vete edhe edukatë, moral, besueshmëri e krenari.

Prandaj, që të jemi të mirë, duhet ta vlerësojmë të autorizuarin për punët që i bën, të veprojmë arsyeshëm.

Respekti dhe mirënjohja janë bazë e vullnetit për punët sfiduese me të cilat ballafaqohet çdo ditë një zyrtar policor.

Përgjegjësia dhe arsyeshmëria na bëjnë të kujdesshëm!

Përgatiti:

**Merita CANOLLI - GASHI**





## **Zyrtarët policorë që intervenuan në incidentin e zjarrit në një ndërtesë kolektive në Fushë Kosovë vizitohen nga drejtori i Policisë, në shenjë mbështetje dhe vlerësimi për punën e tyre në ndihmën ofruar qytetarëve**

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Samedin Mehmeti, i shoqëruar nga drejtori i Departamentit për Operacione, z. Gazmend Hoxha dhe drejtori i Drejtorisë Rajonale të Prishtinës, z. Fahredin Verbovci, me 19 mars realizuan një vizitë zyrtare në Stacionin e Policisë në Fushë Kosovës. Qëllimi i kësaj vizite pune ishte njohja nga afër me punën dhe angazhimet që kryejnë zyrtarët policorë në këtë stacion në parandalimin e krimit dhe ofrimit të sigurisë ndaj qytetarëve, me theks të veçantë takimi ishte i zyrtarëve policorë të cilët intervenuan me profesionalizëm në ofrimin e sigurisë dhe shpëtimin e jetës së qytetarëve në incidentin e zjarrit të ndodhur me 17.03.2021 në një ndërtesë kolektive në Fushë Kosovë. Në shenjë përkrahjeje dhe mbështetje të stacionit policor dhe zyrtarëve që intervenuan në rastin e incidentit të zjarrit, drejtori Mehmeti, dy zyrtarëve iu dhuroi nga një pllakatë policore për punën profesionale që kanë bërë gjatë intervenimit, ku kanë arritur të ofrojnë siguri për qytetarët dhe të shpëtojnë jetën e tyre. Po ashtu një pllakatë policore dhe disa pajisje logjistike (kompjuterë) iu dhuruan komandantin të stacionit policor.



**Qëllimi i kësaj vizite pune ishte njohja nga afër me punën dhe angazhimet që kryejnë zyrtarët policorë në këtë stacion në parandalimin e krimit dhe ofrimit të sigurisë ndaj qytetarëve**

Drejtori Mehmeti falënderoi stafin policor për angazhimet, rezultatet e arritura dhe për punën e tyre të deritanishme në këtë situatë sfiduese nga pandemia dhe njëkohësisht kërkoi nga të njëjtët që të vazhdohet me punë profesionale në interes të vendit dhe të qytetarëve, përderisa menaxhmenti do të vazhdojë ta ketë prioritet përkrahjen dhe mbështetjen në vazhdimësi. Përveç tjerash, nga udhëheqësit dhe mbikëqyrësit e stacionit policor u kërkua që të vazhdohet ngritja e përgjegjësisë në menaxhim dhe mbikëqyrje nga eprorët e të gjitha niveleve, me qëllim të avancimit të metejmë të besueshmërisë dhe imazhit të Policisë së Kosovës, si organizatë profesionale, e thirrur për t'u shërbyer qytetarëve.

# Covid-19



## PATRULLAT POLICORE, TË ANGAZHUARA 24 ORË NË DETYRË

**Policia e Kosovës, në të gjitha rajonet, në zbatim të planit operativ si dhe në zbatim të masave për të parandaluar përhapjen e pandemisë**

Policia e Kosovës (PK), referuar vendimeve të institucioneve të Republikës së Kosovës si dhe referuar planifikimeve operationale policore, të gjitha aktivitetet dhe masat e deritanishme po i ndërmerr në koordinim të plotë me të gjitha institucionet kompetente në fushën e shëndetësisë dhe institucionet e tjera relevante, konform angazhimeve dhe detyrave sipas planit për gatishmëri dhe reagim.


Planifikimet operationale kanë për qëllim bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve me institucionet qendrore dhe lokale që janë kompetentë për luftimin dhe parandalimin e rreziqeve nga virusi në fjalë si dhe përballjen me situatat e këtij lloji, në drejtim të koordinimit dhe reagimit me kohë.

Me qëllim të respektimit të masave mbrojtëse, parandalimit të përhapjes së pandemisë, duke vënë në pah interesin e shëndetit publik, Policia e Kosovës realizon detyra konkrete në gjithë territorin e Kosovës, duke aplikuar kontrole të përbashkëta në trafik, në transportin e udhëtarëve, në qendra tregtare, lokale afariste etj., përfshirë edhe shqiptimin e gjobave ndaj atyre që nuk zbatojnë këto masa.

Policia e Kosovës apelon tek të gjithë qytetarët që t'u përmbahen rregullave dhe t'i respektojnë masat anti-COVID, të mbajnë distancën, të vendosin maskën dhe të pastrojnë duart.

**Përgatiti: Baki KELANI**

Shef i Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun







## Donacioni i pajisjeve të digjitalizimit të dosjeve për personat e pagjetur



Në një ceremoni të organizuar në ambientet e Institutit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, në të cilën ishin të pranishëm zëvendës-drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Fehmi Hoti, ambasadori i Zvicrës, z. Thomas KOLLY, ambasadori i Britanisë, z. Nicholas ABBOTT, znj. Maria Suokko, përfaqësuese e përhershme e UNDP-së, si dhe drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore, z. Arsim Gërçhalii, Policia e Kosovës pranoi një donacion me pajisje për digjitalizimin e dosjeve për personat e pagjetur.

Me që ky donacion korrespondoi me Ditën e Personave të Pagjetur në Kosovë, Policia e Kosovës shprehu konsideratë dhe i falënderoi partnerët për bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme, sepse ky donacion është i një rëndësie të veçantë për punën e Policisë në gjetjen, identifikimin dhe administrimin e rasteve të personave të pagjetur, përmes një procesi të digjitalizimit të këtyre dosjeve.



## Nën moton “Duaje jetën - duaje veten”, Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicën e Jugut, zhvilloi aktivitet të veçantë

Krahas angazhimeve të vazhdueshme policore, Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicën e Jugut, gjatë ditës së sotme ka zhvilluar një aktivitet sensibilizues, në kuadër të vazhdimësisë së projektit të nisur “Parandalimi i vetëvrasjeve”, të filluar nga muaji tetor i vitit 2020. Në promovim dhe mbështetje të realizimit të projektit, në këtë aktivitet mori pjesë edhe drejtori rajonal, kolonel Afërdita Mikullovc.

Referencë për iniciimin dhe realizimin e një projekti të kësaj natyre ishte hulumtimi i realizuar një vit më parë nga DRP-ja e Mitrovicës, hulumtim i cili kishte për qëllim identifikimin e faktorëve dhe motiveve që çojnë në kryerjen e akteve të tentim-vetëvrasjeve dhe vetëvrasjeve.

Me qëllim të parandalimit të kësaj

dukurie mjaft shqetësuese si për individin, familjen dhe shoqërinë në tërësi, në bashkëpunim me OJQ-në “Diakonie”, është përgatitur projekti dhe janë identifikuar target-grupet për veprim të përbashkët dhe fazat e veprimit të projektit.

Në fazën e parë, bashkë me psikologë të OJQ-së “Diakonie” janë realizuar ligjërata me nxënësit e shkollave të mesme të rajonit të Mitrovicës. Ndërsa në fazën e dytë është planifikuar përzgjedhja dhe përgatitja e mesazheve motivuese për jetën e të cilat mesazhe besohet se do të ndikojnë në parandalimin e dukurisë në fjalë.

Rreth 150 mesazhet me përmbajtje të kësaj natyre janë shpërndarë nga zyrtarët policorë dhe psikologët nëpër sheshe, parkun e qytetit, liqenin akumulues dhe në urën kryesore mbi lumin Ibër në Mitrovicë, si vendet më të frekuentuara nga qytetarët. Realizimi i këtij projekti edhe një herë dëshmon përkushtimin e vazhdueshëm të Policisë, që në partneritet me komunitetin dhe OJQ-të, të shërbejë si model i bashkëpunimit të ndërsjellë në promovimin e vlerave individuale, kolektive për një ngritje të vetëdijesimit në parandalim të dukurive negative dhe kontribut në sigurinë e përgjithshme.





## Në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), me 18 janar 2021, filloi trajnimi i gjeneratës së 56-të të kadetëve policorë

Në ambientet e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike fillimi i trajnimit të gjeneratës së 56-të karakterizohet fillimisht me nënshkrimin e kontratës nga kadetët policorë.

Kadetëve të rinj mirëseardhje iu dëshiruan stafi menaxhues nga Divizioni i Trajnimit të Policisë së Kosovës së bashku me instruktorë policorë, të cilët njëkohësisht iu dëshiruan suksese dhe i inkurajuan që të angazhohen maksimalisht në marrjen e njohurive teorike dhe praktike, në mënyrë që këto njohuri të fituara t'i zbatojnë pas fillimit të punës në stacione policore.

Përmes këtij trajnimi kadetët policorë marrin njohuritë e nevojshme sipas standardeve më të larta evropiane, për t'i kryer detyrat me profesionalizëm në shërbim të qytetarëve. Policia e Kosovës në bashkëpunim me AKSP-në po i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që janë të përcaktuara nga IKSHPK-ja për mbajtjen e trajnimit/mësimit gjatë situatës me pandeminë.

Përgatiti: Çajup Kajtazi



## Infermierja e policisë që me punë e pozitivitet e përballon çdo vështirësi

**Ajo tregon se gjatë këtyre 16 viteve punë në Polici, viti 2020 dhe fillimi i vitit 2021 kanë qenë ndër vitet më sfiduese në punë. Gjatë kësaj periudhe të shfaqjes së pandemisë i tërë stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore ka qenë i ballafaquar dhe i angazhuar maksimalisht në drejtim të ruajtjes së shëndetit publik e në veçanti të ruajtjes dhe kujdesit për shëndetin e pjesëtarëve të PK-së**

Antigona Imeri Zejnullahi është e lindur në Drenas. Shkollën fillore e ka mbaruar po aty, kurse shkollën e mesme të mjekësisë “Dr Ali Sokoli” në Prishtinë, në drejtimin Mjekësi e Përgjithshme.

Ajo ka studiuar në degën e Psikologjisë, kurse studimet MASTER i ka mbaruar në drejtimin Psikologji Klinike. Përveç shkollimit ka vazhduar me trajnime të ndryshme nga fusha e mjekësisë dhe psikologjisë, studime këto që e kanë plotësuar Antigonen profesionalisht.

Nga viti 1999 ka filluar të punojë në Shtëpinë e Shëndetit në Drenas, në vitin 2002 ajo ka kaluar në QKUK, konkretisht në Klinikën Interno, kurse nga vitit 2005 ka filluar punën në Drejtorinë e Shërbimeve Shëndetësore në Policinë e Kosovës. Vullneti për punë, angazhimi dhe përkushtimi i pakursyeshëm për punën profesionale në Polici ka bërë që ajo të shpërblehet me lëvdata e mirënjohje të shumta, në shenjë falënderimi.

Antigona gjatë kësaj periudhe të punës në Polici (rreth 16 vjet), ka pasur edhe sfida, por është ndier mirë kur ka arritur që me punën e saj t’ua lehtësojë sadopak dhimbjet nga sëmundjet ose lëndimet e ndryshme kolegëve të saj.

Ajo ka qenë çdo herë e angazhuar me ekipin mjekësor gjatë operacioneve të ndryshme që ka zhvilluar Policia, përfshirë edhe rastet e përcjelljeve të rëndësishme, ku ka qenë pjesë e eskortave.

Përveç punëve që i përmendëm, në përditshmërinë e zakonshme, infermierja Antigona bën kompletimin e dokumentacioneve mjekësore për punonjësit e Policisë, merret me kërkesa që i drejtohen Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore për raste të natyrave të ndryshme, iu bën vizita në spital dhe në shtëpi private policëve që janë të lënduar në



detyrë apo edhe të sëmurë me sëmundje të tjetra.

Antigona është e angazhuar edhe në ofrimin e ndihmës mjekësore dhe këshillave mjekësore për stafin e PK-së të cilët kanë nevojë për këto shërbime.

Ajo tregon se gjatë këtyre 16 viteve punë në Polici, viti 2020 dhe fillimi i vitit 2021 kanë qenë ndër vitet më sfiduese në punë. Gjatë kësaj periudhe të shfaqjes së pandemisë i tërë stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore ka qenë i ballafaquar dhe i angazhuar maksimalisht në drejtim të ruajtjes së shëndetit publik e në veçanti të ruajtjes dhe kujdesit për shëndetin e pjesëtarëve të PK-së. Paraqitja e pandemisë, siç dihet, ka qenë e panjohur më parë, por edhe përballja me të kanë qenë stresuese dhe sfiduese.

Me paraqitjen e rasteve të para me COVID-19, Antigona bashkë me stafin tjetër të Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore (DSHSH), janë angazhuar rreth mbajtjes së ligjëratave vetëdijesuese, fillimisht për Policinë Kufitare e pastaj edhe për njësitet e tjera të PK-së, po ashtu kanë përgatitur posterë informues, me qëllim që stafi punonjës të kenë informata si të mbrohen nga virusi.

Sfidë tjetër ka qenë edhe furnizimi me mjete mbrojtëse dhe administrimi i tyre. Gjatë kësaj periudhe më shumë se një





vjeçare, angazhimet në punë kanë qenë me orar të zgjatur dhe Antigona ka punuar me përkushtim, duke mos u kursyer aspak në ofrimin e shërbimeve mjekësore për të prekurit nga virusi e që nuk ishin të paktë në kuadër të pjesëtarëve të PK-së. Edhe pse orari ka qenë i tejzgjatur dhe i lodhshëm, ajo është ndier mirë kur ka parë se me punën e saj ka arritur t'ua lehtësojë sadopak nevojat të prekurve me COVID-19.

Momente të vështira gjatë përballjes me pandeminë kanë qenë kur kolegë nga PK-ja kanë humbur betejën me virusin.

Ajo kujton me dhimbje edhe bisedat me ta, i kujton edhe momentet gjatë trajtimit, i kujton edhe fjalët shpresëdhënëse që ua ka folur.

Infermierja Antigona gjatë angazhimeve të pandërprera, edhe përkundër marrjes së masave mbrojtëse, në nëntor 2020, pasi ka vërejtur disa simptoma të pazakonta, pas testimit ka rezultuar pozitiv me virusin COVID-19. Ajo thotë se virusi nuk ka qenë i lehtë. Ndër shqetësimet që ajo i ka përjetuar kanë qenë lodhja e theksuar, përjetim i ankthit, pagjumësia, simptoma këto

që në përgjithësi e karakterizojnë këtë virus. Trajtimin e ka bërë në shtëpi dhe terapitë i ka marrë në konsultim me stafin e DSHSH-së, të cilët i falënderon për ofrimin e përkrahjes dhe ndihmës mjekësore gjatë kësaj periudhe.

Antigona duke qenë edhe profesioniste shëndetësore, por edhe duke qenë se e ka kaluar virusin COVID-19, ka një porosi për të gjithë, ajo apelon që të respektohen të gjitha masat e rekomanduara nga IKSHPK-ja dhe profesionistët e tjerë shëndetësorë në lidhje me parandalimin e përhapjes së pandemisë.

Së fundmi, në kuadër të vaksinimit të stafit mjekësor edhe Antigona është vaksinuar me vaksinën anti - COVID-19 dhe me këtë rast apelon që të vaksinoheni që në rastin e parë që u jepet mundësia. Ajo tregon se vaksina ka qenë e njëjtë për nga efektet si çdo vaksinë tjetër.

Antigona është e martuar dhe ka tre fëmijë dhe së bashku me familjen jeton në Prishtinë.

Gërshetimi i angazhimeve të jetës familjare dhe asaj profesionale Antigona e përmbush shpirtërisht, i jepë motiv duke bërë që ajo gjithnjë të rezultojë pozitivitet në paraqitje.

Profesionalizmi, bashkuar me humanitetin, i bën njerëzit të fuqishëm.

Interviewtoi:  
**Merita Canolli - Gashi**



# Siguria në trafikun rrugor

## ROLI DHE ANGAZHIMI I DIVIZIONI


Roli i Divizionit të Komunikacionit Rrugor (DKRr) të Policisë së Kosovës është të zbatojë legjislacionin mbi trafikun rrugor dhe të hartojë plane strategjike të cilat ndikojnë në parandalimin e aksidenteve të trafikut rrugor. Divizioni i Komunikacionit Rrugor bën analizimin, vlerësimin, planifikimin dhe hartimin e strategjive për zhvillimin e integruar dhe të qëndrueshëm të sigurisë në trafik në nivel vendi.

### Siguria në trafikun rrugor

Siguria në trafikun rrugor vazhdon të mbetet sfidë jo vetëm për Kosovën, por edhe për shumë shtete të Evropës dhe të botës. Për të adresuar këtë sfidë, Policia e Kosovës në vazhdimësi bën përpjekje të mëdha që të ngrihet siguria në trafikun rrugor, duke përdorur një qasje të ofrimit të sigurisë përmes parandalimit dhe zbulimit të të gjitha aktiviteteve që mund të ndikojnë në sigurinë e përgjithshme të trafikut rrugor, bashkëpunimin, bashkërendimin



**MOS VENDOSJA E RRIPI TË SIGURISË MUND TË RRIJË SHUMË RREZIKUN E NJË LËNDIMI SERIOZ GJATË NJË PËRPLASJEJE NË AKSIDENT TRAFIKU DHE MUND TË JETË PËRGJEGJËSE PËR SHUMË VDEKJE NË RRUGË**



**ME VEPRIMIN E THJESHTË TË VENDOSJES SË RRIPI TË SIGURISË NË MJETIN TUAJ, LËNDIMET E RËNDA DHE FATALITETET NË PËRPLASJE MUND TË ZVOGËLOHEN NË MËNYRË DRAMATIKE**

dhe koordinimin e veprimeve policore, me theks të veçantë ndërmjet njësive policore, pastaj ato ndërinsticionale, ndërkombëtare, mediave, shoqërisë civile si dhe ekspertëve të ndryshëm të fushës së sigurisë në trafikun rrugor, e

cila ngërthen edhe orientimin strategjik të adresimit të sfidave në trafikun rrugor.

Në kuadër të sistemit gjithëpërfshirës të ofrimit të sigurisë në trafikun rrugor dhe në kuadër të sistemit të decentralizuar të menaxhimit të njësive të trafikut rrugor e cila mbretëron në Policinë e Kosovës, DKRR është përgjegjëse për orientimin strategjik në adresimin e sigurisë në trafikun rrugor. Ndërsa, në nivel operacional, DKRr është përgjegjëse për menaxhimin e Njësive për Kontroll të Autostradave, Njësive për Përcjelljen e Materieve të Rrezikshme dhe Njësive për Përcjelljen e Personaliteteve të Rëndësishme.

Ky divizion (DKRr) është përgjegjës për zhvillimin strategjik të Njësive Rajonale të Komunikacionit Rrugor (NJRKRr), ku pjesë e detyrave dhe përgjegjësisë së NJRKRr-ve është ofrimi i sigurisë në trafikun rrugor si dhe ngritja e nivelit të vetëdijesimit të pjesëmarrësve në trafikun rrugor, ndërsa menaxhimi i njësive në fjalë bëhet nga ana e strukturës përkatëse të Drejtorisë Rajonale të Policisë. NJRKRr-të me aktivitetet e tyre mbulojnë 665.17 km rrugë magjistrale dhe 1473.52 km rrugë rajonale.






# T TË KOMUNIKACIONIT RRUGOR

Në kuadër të aktiviteteve të tij Divizioni i Komunikacionit Rrugor përkrah edhe aktivitetet e ndryshme evropiane dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me sigurinë rrugore, e në rastin konkret i është bashkëngjitur Rrjetit Evropian të Policive Rrugore (European Roads Policing Network), në realizim të operacionit "roadpol"<sup>1</sup> - rripi i sigurisë, nga data 08-15.03.2021, duke hartuar dhe realizuar planin operativ roadpol - rripi i sigurisë, me ç'rast nga Policia e Kosovës janë shqiptuar gjithsej 4579 tiketa lidhur me këtë operacion.

Divizioni i Komunikacionit Rrugor ka realizuar edhe fushata vetëdijesuese, si: "Shpejtësia vret", "Kujdes të shtuar gjatë ngasjes në rrugë me ngrica", "Mos shpejto, familja të pret!", "Pakujdesia juaj shkakton vujtje për të tjerët", "Vendos rripin e sigurisë", e të cilat fushata janë përcjellë me komunikata përmes rrjeteve sociale të PK-së.

Marrë parasysh se vendi ynë sikurse i tërë globi po ballafaqohet me pandeminë si pasojë e virusit Covid-19, edhe Policia e Kosovës, e në këtë rast DKRR, në vazhdimësi është e angazhuar në zbatim të urdhrat operativ UO "Gatishmëri dhe reagim për virusin Covid-19", me qëllim të parandalimit të këtij virusi.

Ndërsa, lidhur me bashkëpunimin rajonal është e rëndësishme të theksohet se nga viti 2010 e tutje në vazhdimësi për çdo sezonë verore është nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi për organizimin e shërbimeve të policimit rrugor të Policisë së Shtetit Shqiptar dhe Policisë së Kosovës në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përpjekje për ngritjen e nivelit të sigurisë në trafikun rrugor, parandalimin e aksidenteve dhe kundërvajtjeve në trafik, shpëtimin e jetëve të njerëzve në aksidente rrugore, si



dhe zbatimin me rigorozitet të ligjeve dhe rregullave në fushën e trafikut rrugor. Përjashtimisht ky memorandum nuk është realizuar në vitin 2020 për shkak të situatës me pandeminë "COVID-19".

Kurse, sa u përket analizave krahasuese statistikore me vendet e Ballkanit Perëndimor, Sekretariati i Traktatit të Komunitetit të Transportit Rrugor dhe Komisioni Evropian, me datën 20.04.2021, kanë publikuar statistikën për vdekjet në aksidentet e trafikut rrugor për vitin 2020 dhe krahasimin 2010-2020 për 1 milion banorë, për të gjitha shtetet anëtare. Në këtë publikim janë përfshirë edhe vendet e Ballkanit Perëndimor, si: Shqipëria,

Maqedonia e Veriut, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia. Bazuar në tabelat e paraqitura në vijim vërehet se Kosova krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2020 dhe krahasimin e aksidenteve 2010-2020, ka më së paku vdekje për 1 milion banorë.

Divizioni i Komunikacionit Rrugor mbetet i përkushtuar dhe i angazhuar për realizimin e detyrave dhe aktiviteteve, me qëllim të ngritjes së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në trafikun rrugor.

Përgatiti:  
**Nënkolonel Jeton REXHEPI**  
Drejtore i Divizionit të Komunikacionit Rrugor

<sup>1</sup> Linku i aktiviteteve nga ROADPOL: <https://www.roadpol.eu/index.php/calendar-dates/25-roadpol-operation-seat-belt>

<sup>2</sup> Fatalities for 2020 annual statistics for western balkans

<sup>3</sup> Linku i statistikave: <https://www.transport-community.org/wp-content/uploads/2021/04/Annual-Statistics-2020.pdf>

Linku i statistikave: [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip\\_21\\_1767?utm\\_source=ETSC&utm\\_campaign=71073a749a-20200709-PIN\\_corona\\_briefing\\_COPY\\_01&utm\\_medium=email&utm\\_term=0\\_3a7b55edbf-71073a749a-136654993](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_21_1767?utm_source=ETSC&utm_campaign=71073a749a-20200709-PIN_corona_briefing_COPY_01&utm_medium=email&utm_term=0_3a7b55edbf-71073a749a-136654993)

## Policia e Kosovës më afër qytetarëve edhe përmes internetit

Pas ridizajnimit të web faqes së PK-së gjatë vitit 2020 dhe lansimit të webit të ri ([www.kosovopolice.com](http://www.kosovopolice.com)), web faqja e Policisë së Kosovës si rrjedhojë ka pasur një rritje të konsiderueshme të vizitave, që do të thotë vetëm gjatë vitit 2020, web faqen e Policisë së Kosovës e kanë vizituar rreth 1.076,033 vizita brenda vitit.

Ndërsa, faqja zyrtare e Policisë së Kosovës në rrjetin social 'Facebook' <https://facebook.com/Kosovopolice/> vetëm gjatë vitit 2020, ka pasur 64.0k ndjekës, që në krahasim të vitit të kaluar tregon rritje të konsiderueshme për PK-në.

Ndërsa nga postimet më të shikuara në faqen zyrtare të PK-së në Facebook vend të rëndësishëm kanë zënë pikërisht postimet që kanë të bëjnë në shërbim të qytetarëve, si rrjedhojë pikërisht shkrimi i cili është postuar me 11.04.2020 që ka të bëjë me personin e zhdukur ka realizuar një plan kërkimi për qytetarin B. O., i cili është paraqitur si 'person i zhdukur' me datën 24.03.2020. Pas angazhimit të 96 zyrtarëve policorë të njësisë të ndryshme policore, përfshirë Njësinë K9 (njësia me qen), janë realizuar kërkimet në zonën e fshatit Muqibabë, në një terren malor dhe mjaft të vështirë për kërkim. Ky shkrim ka arritur shikueshmërinë deri në 104.7k (104 666 persona), ndërsa kanë reaguar, komentuar dhe kanë shpërndarë këtë informatë 4 833 persona.

Vend të rëndësishëm zënë edhe postimet që kanë të bëjnë me personat në kërkim, pra nëse iu referohemi shifrave, vetëm gjatë vitit 2020, postimet në përgjegjësi që kanë të bëjnë me personat në kërkim kanë arritur shikueshmërinë deri në 71k.

Gjithashtu vëmendje të konsiderueshme iu kanë kushtuar edhe rekomandimeve pas situatës dhe rrethanave të krijuara në vendin tonë nga pandemia, virusi 'COVID-19', që vlen të theksohet se



| Rank | Entity                        | Followers | Change | Engagement |
|------|-------------------------------|-----------|--------|------------|
| 1    | Kosovo Police                 | 64,000    | +36%   | 1,076,033  |
| 2    | Kosovo Police (Official Page) | 64,000    | +36%   | 1,076,033  |
| 3    | Kosovo Police (Official Page) | 64,000    | +36%   | 1,076,033  |
| 4    | Kosovo Police (Official Page) | 64,000    | +36%   | 1,076,033  |
| 5    | Kosovo Police (Official Page) | 64,000    | +36%   | 1,076,033  |
| 6    | Kosovo Police (Official Page) | 64,000    | +36%   | 1,076,033  |

nga çdo postim apeli që është bërë kanë arritur shikueshmëri rekorde deri në 71,7K.

Vlen të theksohet se edhe shkrimi që ka të bëjë me aplikacionin e ri që ka nxjerrë Policia e Kosovës "Lajmëro Policinë" ka pasur interesim të kënaqshëm ka arritur deri në 30.4k.

Gjithashtu vëmendje të konsiderueshme iu kanë kushtuar edhe vizitave që kanë bërë menaxhmenti i zyrtarëve policorë, si rasti i vizitës tek zyrtari policor Mazllum Bajraktari i cili ishte lënduar

gjatë kryerjes së detyrës zyrtare para 14 vitesh. Ky shkrim i postuar ka arritur shikueshmërinë 39 395 (39,4K) persona dhe është komentuar me 114 komente.

Sa i përket postimit rekord për vitin 2020, është pikërisht lajmi i hidhur që një zyrtar policor (polici Sami THAQI) ka humbur jetën gjatë kryerjes së detyrës zyrtare me datën 28.01.2020, në aksionin e Policisë në fshatin Zhur të Prizrenit, pra ky shkrim ka prekur thellë ndjenjat dhe është shikuar nga mbi 199 863 persona dhe është komentuar me mbi 2,8 mijë komente.

Tani faqja zyrtare në Facebook ka gjithsej 64.0k ndjekës aktivë në rrjetin social të PK-së.

Policia e Kosovës ka qenë vazhdimisht e përkushtuar në ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me publikun, mediumet elektronike dhe të shkruara, me qëllim të rritjes së transparencës për veprimet policore. Gjithashtu ka mbështetur dhe promovuar disa fushata sensibilizuese në interes të përgjithshëm shoqëror, me theks të veçantë në fushën e sigurisë dhe pandemisë Covid 19.

Gjatë periudhës raportuese në nivel qendror të Policisë:

- janë lëshuar 118 komunikata me shkrim për media;
- janë publikuar 365 raporte 24-orëshe;
- janë publikuar 170 aktivitete të ndryshme policore në rrjetet sociale të Policisë;
- janë dizajnuar dhe janë publikuar 45 projekte policore;
- është hartuar dhe është publikuar revista e Policisë së Kosovës "MBROJTËSI" dhe
- janë publikuar videospote, broshura vetëdijesuese lidhur me aplikacionin e Policisë së Kosovës "Lajmëro Policinë". Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj.

Përgatiti: Çajup KAJTAZI





## Disa persona hasin në vështirësi (bllokohen) në Bjeshkët e Zhurit si pasojë e dëborës, Policia Kufitare e Kosovës i shpëton me motosajë

Pas intensifikimit të reshjeve të borës, me 23 mars 2021, në vendin tonë, Policia e Kosovës ka qenë e angazhuar në terren me njësitet e saj, pavarësisht kushteve dhe rrethanave atmosferike që kanë mbretëruar. Njëkohësisht është kërkuar nga të gjithë që të kenë kujdes të shtuar gjatë qarkullimit apo lëvizjes nëpër rrugë apo zona të ndryshme gjatë reshjeve atmosferike.

Me datën 22.03.2021, në orën 11:40, në Policinë e Kosovës është pranuar një informatë se në Bjeshkët e Zhurit kishin mbetur të ngjuar nga dëborë dy (2) persona të cilët ishin nisur në këmbë rrugës malore por që kishin vështirësi për të arritur në Zhur.

Menjëherë Policia ka filluar organizimin e operacionit të kërkimit dhe shpëtimit të këtyre personave dhe ka arritur që përmes kontaktit me ta të kuptojë se janë gjithsej katër (4) persona që janë larg dhe kanë vështirësi. Nga Stacioni Policor për Mbikëqyrjen e Kufirit (SPMK) në Vërmicë janë angazhuar dy (2) automjete, një motosajë dhe katër (4) zyrtarë policorë.

Pas disa orë kërkimi nga Policia është arritur kontakti fizik me personat e mbetur në mal, për të arritur pastaj në Zhur. Rreth orës 16:00 të së njëjtës ditë, duke e ndjerë veten në gjendje të mirë dhe pa pasur nevojë për ndonjë trajtim mjekësor personat në fjalë janë kthyer në shtëpi shëndosh e mirë.

Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar t'i u shërbejë të gjithëve pa dallim dhe të ofrojë ndihmën e nevojshme kudo dhe kurdo që qytetarët kanë nevojë apo konsiderojnë që Policia mund t'ju dalë në ndihmë.

Vetëm përmes një bashkëpunimi aktiv situatat e vështira mund t'i tejkalojmë më lehtë.

**Policia, bashkë me ekipet zjarrfikëse, reagojnë në një rast zjarri, ku parandalojnë më të keqen**



Policia e Kosovës, me 12 janar 2021, rreth orës 15:10, ka pranuar një informacion se në fshatin Babush të Lipjanit ka shpërthyer një zjarr në një objekt ndihmës të një shtëpie.


Reagimi policor në përgjigje të këtij njoftimi ka qenë shumë i shpejtë. Njësitet policore që i janë përgjigjur rastit kanë kryer detyrat e tyre në përputhje me situatën tilla, duke i dhënë rëndësi sigurisë së përgjithshme për jetën e qytetarëve.

Sipas shikimit të vendit të ngjarjes dhe informatave të pranuar nga pronari i objektit, deri tek zjarri kishte ardhur kur pronari i cili duke kryer punë në atë objekt me aparate të ndryshme, ka vërejtur se ka filluar të dalë tym.

Në objekt kishte një sasi prej 1500 litra naftë për ngrohje, boca gazi (plini) 20 litërshe, boca me CO2 dhe mjete tjera të punës.



# KORONAVIRUSI DHE



Gjatë pandemisë së koronavirusit duhet të kemi fokusin e drejtuar në shëndetin mendor po aq sa edhe kujdesin për shëndetin fizik.

Aktualisht bota është në gjendje stresi. Pandemia e koronavirusit ka nxitur njerëzit të blejnë nga paniku, qoftë gjëra ushqimore, farmaceutike, për mirëmbajtje të higjienës dhe për pastrim.

Hulumtimi në rrjetet shoqërore, portale apo edhe në forma tjera në kërkimin e informacioneve më të reja se si të mbrohemi ndaj infektimit dhe brengosja se me kë mund të takohemi dhe si mund ta refuzojmë.

**Kjo është shumë për t'u kapërdirë në një kohë të shkurtër dhe fluksi i ndikimeve nga jashtë është i madh**

Njerëzit të cilët më herët nuk kanë pasur probleme me shëndetin psikologjik, përnjëherë kanë problem me gjumin, me ushqyeshmëri të rregullt, përqendrim e njëkohësisht edhe në jetën normale të përditshme.

Ata të cilët më parë kanë vuajtur nga ankthi apo nga çrregullimi i ideve fikse dhe sjelljeve përsëritëse, ndikimi negativ i informacioneve nga mundësia e infektimit me virusin korona e informata tjera në raport me virusin kanë përkeqësuar simptomat që i kanë patur.


## Ruajtja e shëndetit emocional e psikologjik

Tani, më shumë se kurdoherë, duhet të ruajmë shëndetin mendor dhe ta bëjmë sa më funksional në raport me gjendjen me të cilën jemi duke u ballafaquar.

Problem tjetër është shpejtësia e përhapjes së lajmeve mbi koronavirusin dhe sa shpejt ato informacione ndryshojnë. Mirëpo edhe më e keqe është sasia e "lajmeve të rreme", të cilat qarkullojnë. Është njerëzore të ndiesh nevojën që të jesh i informuar, askush nuk dëshiron të rrezikojë që të infektohet me këtë sëmundje.

Pasiguria dhe ndjenja e mungesës së kontrollit janë prapavijë e ankthit. Pritet diçka të ndodhë, ndërsa ajo vetvetiu zgjon ankth.

Edhe një problem shtesë janë protokollet e reja rreth larjes së duarve dhe mosprekjes së fytyrës, veç tjerash, mund të përkeqësojnë gjendjen te disa njerëz me çrregullim fiksimit të sjelljeve përsëritëse. Njerëzit me çrregullim fiksimit dhe sjellje përsëritëse tashmë pastrojnë gjërat në mënyrë të vazhdueshme, siç janë dorezat e dyerve, të kuzhinës dhe banjës sërisht e sërisht. Kjo mbase edhe nuk tingëllon tepër keq, mirëpo kur kjo vazhdon për kohë të gjatë atëherë shkakton probleme në funksionimin e përditshëm, duke lënë anash obligimet dhe detyrat ditore në familje, punë e jeti.



Cilët janë hapat në uljen e gjasave që COVID-19 të ndikojë negativisht në shëndetin tonë mendor?

## Kufizoni leximin e lajmeve

Të gjithë dëshirojmë të jemi në rrjedha, mirëpo kemi nevojë për pushim, posaçërisht nga ajo që tani po ndodh. Kufizojeni kohën të cilën e kaloni në rrjetet sociale duke shikuar lajme. Kjo do t'ju japë hapësirë për gjëra të tjera. Duhet të jini të rreptë në reduktimin e kohës për lajmet lidhur me COVID-19, nuk do të jetë e lehtë.

## Ushtroni në kushte shtëpiake

Dihet që ushtrimet i bëjnë mirë shëndetit mendor, kështu është edhe



# SHËNDETI MENDOR



tani. Madje edhe nëse jeni të kufizuar në shtëpinë tuaj, ende mund të shëtisni nëpër kopsht, oborr, të ngjitni shkallët apo madje të bëni “aerobi në karrige”, ushtrimet për njerëzit me lëvizshmëri më të vogël, të cilët mund të bëhen derisa qëndroni ulur në karrige, me muzikën e preferuar.

## Dilni në ajër të freskët

Kufizimi i lëvizjes në ambiente të hapura, si parqe e vende publike, nuk do të thotë se nuk mund të shfrytëzohet ambienti tjetër, p.sh. nëse jetoni në shtëpi me oborr shfrytëzoni oborrin për ajër të pastër, nëse jetoni në banesa kolektive dilni në ballkon që të merrni ajër të pastër.

Ajri i pastër ndihmon në uljen e simptomave dhe në shërimin e ankthit dhe çrregullimit të humorit. Dhe provoni të mos shikoni në telefon.



## Kufizojeni kohën e brengave

Nëse e kapni veten duke i përsëritur veprimet nga frika e prekjës me virusin korona, kufizojeni kohën se sa herë i lani duart dhe pastroni sipërfaqet. Kufizoni “kohën e brengave” për një orë të caktuar çdo ditë dhe pastaj provoni të mos mendoni gjatë pjesës tjetër të ditës.

## Ndjeni e mendoni në mënyrë pozitive

Mbi të gjitha, mos pushoni që të ndieni se nuk do të prekeni nga virusi dhe se shumica e njerëzve të cilët infektohen me koronavirus kanë simptoma të buta dhe shërohen plotësisht.

Mundohuni që gjithmonë t’i shikoni gjërat në aspektin pozitiv, kjo ka ndikim të mirë në ruajtjen e shëndetit mendor, në reduktimin dhe uljen e ndikimit të stresit, ankthit, panikut, sjelljeve përsëritëse e ideve fikse në luftë me virusin. Sa herë që të keni mundësi bisedoni me personin që e konsideroni të afërt dhe të besueshëm, mundohuni maksimalisht të bisedoni për jetën, të mirat që i sjell jeta, kontributin që mund të jepni karshi secilës sfide që mund ta hasim në rrugëtimin tonë të përditshëm.

Përmbajuni rekomandimeve të dhëna nga organet gjegjëse të kujdesit të shëndetësor dhe profesionistëve shëndetësorë për ruajtjen dhe marrjen e masave parandaluese nga infektimi me virusin korona.

E fundit, por jo më e pavlera, besoni në Zot, lutuni për jetë, falënderojuni

**Mbi të gjitha, mos pushoni që të ndieni se nuk do të prekeni nga virusi dhe se shumica e njerëzve të cilët infektohen me koronavirus kanë simptoma të buta dhe shërohen plotësisht.**

**Mundohuni që gjithmonë t’i shikoni gjërat në aspektin pozitiv, kjo ka ndikim të mirë në ruajtjen e shëndetit mendor, në reduktimin dhe uljen e ndikimit të stresit, ankthit, panikut, sjelljeve përsëritëse e ideve fikse në luftë me virusin**

për secilën ditë të jetuar, jini krenar për kontributin tuaj, mos harroni se kemi përgjegjësi edhe për njerëzit që na rrethojnë, siç janë bashkëshorti/ja, prindërit, fëmijët, motrat e vëllezërit, kolegët e shumë njerëz me të cilët jemi të rrethuar.

Përgatiti:

**Psikolog Arton ADEMI**

Drejtoria e Sherbimeve Shëndetësore e PK-së



## **Policia e Kosovës në bashkëpunim me autoritetet shqiptare, italiane dhe me DEA-në amerikane arrijnë sekuestrimin e 400 kilogramëve kokainë Kosovë**



Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria e Hetimit të Trafikimit me Narkotikë në koordinim me Policinë Italiane dhe Shqiptare, pas një hetimi të përbashkët gjatë kontrollit në depon e një kompanie kanë gjetur dhe sekuestruar një sasi substancë të dyshuar narkotike të llojit kokainë në peshë prej 400 kg, ndërsa gjatë kontrollit në disa lokacione të tjera janë gjetur dhe sekuestruar: dy revole; një "TT" dhe tjetra me gas, 50 copë fishekë të kalibrit. 7.62 mm, 25925 € para kesh, 200 denarë MK, një veturë, 6 telefona celularë, 6 kompjuterë, dy lloptopë, katër DVR dhe një hard disk. Të gjitha veprimet janë ndërmarrë në konsultim me gjyqtaren e procedurës paraprake dhe prokurorin e Prokurorisë Speciale. Shtatë (7) të dyshuar meshkuj kosovarë janë arrestuar dhe me vendim të prokurorit janë dërguar në mbajtje. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Samedin Mehmeti gjatë një konference tha se janë arrestuar shtatë (7) persona, ndërsa aksioni po vazhdon dhe mund të ketë edhe arrestime të tjera.

"Policia dhe Prokuroria kanë formuar një grup të përbashkët për hetimin e këtij rasti. Institucionet e tri shteteve kanë bashkëpunuar në kohë reale dhe në mes të këtyre institucioneve pati një komunikim të rregullt.

Ngarkesa është ndalur në parkingun e një depoje mirëpo gjatë tërë kohës u mbikëqyr nga Policia. Sot rreth orës 11 të dyshuarit kanë filluar aktivitetin kriminal. Policia ka ndërhyrë. Kanë arritur të arrestojnë të dyshuarit dhe rreth 400 kilogramë narkotikë të llojit kokainë. Janë bastisur edhe lokacione të tjera.

Besohet se kamioni ka ardhur nga Brazili duke kaluar nga disa shtete përmes Kosovës. Kokaina ishte e



fshehur në pako të llojeve të ndryshme të mishit. Janë arrestuar shtatë (7) persona shtetas të Kosovës, janë konfiskuar rreth 400 kg narkotikë, një armë dhe lloje të ndryshme te veturave. Operacioni po vazhdon, mund të ketë edhe arrestime të tjera".

## **Bashkëpunimi ndërkombëtar policor jep rezultate në shkatërrimin e grupeve kriminale të organizuara**



Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës dhe Policia e Kosovës, respektivisht Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar, kanë realizuar

operacionin e dytë të suksesshëm policor ndaj dy grupeve kriminale të përfshira në veprën penale "Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar" që lidhen me "Kontrabandë me migrantë" dhe "Falsifikim i dokumenteve". Operacioni i parë është zhvilluar me datën 29 tetor 2020, ku janë kontrolluar pesë (5) lokacione të ndryshme dhe janë arrestuar tre (3) persona të dyshimtë. Ndërsa, në operacionin e dytë janë kontrolluar dymbëdhjetë (12) lokacione dhe janë arrestuar nëntë (9) persona të dyshimtë, përdërisa dy të tjerë janë liruar në procedurë të rregullt. Gjatë kontrollit të lokacioneve në të dy këto operacione policore janë gjetur punëtori (laboratorë) të pajisur me aparaturë dhe materiale që janë shfrytëzuar për prodhimin e dokumenteve të ndryshme të falsifikuara, si dhe me qindra dokumente të falsifikuara, si: pasaporta, kartela identifikimi, patentë shoferi të falsifikuara të më shumë se gjashtëmbëdhjetë (16) shteteve të ndryshme, kryesisht të vendeve të BE-së. Në të dy këto operacione policore janë arrestuar gjithsej dymbëdhjetë (12) persona të dyshuar, të cilët me urdhër të prokurorit gjenden në mbajtje e të tjerët në paraburgim sipas vendimit të gjykatës. Në të dy këto raste, hetimet janë kryer në bashkëpunim me: EUROPOL-in, Shqipërinë si dhe disa shtete të BE-së. Në cilësi të prova materiale janë sekuestruar aparaturat, materialet që janë shfrytëzuar për kryerjen e veprave penale si dhe dokumentet e falsifikuara dhe prova të tjera materiale..

## **Sekuestrohet një shumë e madhe bankënotash që dyshohet të jenë të falsifikuara, Policia e Kosovës arreston gjashtë persona të dyshuar**

Me 3 prill 2021, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK) ka pranuar informacione





nga Dogana e Kosovës për një pako të dyshuar, e cila përmes postës nga Turqia ishte dërguar për në Kosovë, saktësisht në Mamushë.

Në këtë pako dyshohej se kishte para që mund të ishin të falsifikuara. Drejtoria Kundër Krimeve Ekonomike e PK-së (DHKEK), në koordinim me Prokurorinë e Shtetit, ka zbatuar masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit dhe kjo pako ka qenë nën masat e vëzhgimit deri në destinacionin e caktuar.

Me 02.04.2021, sipas procedurave kjo pako është tërhequr nga posta në Mamushë nga personi për të cilin ishte destinuar, i cili ishte në shoqëri edhe të disa personave të tjerë. Më pas Policia ka reaguar dhe të gjithë personat që janë ndërlidhur me këtë rast janë arrestuar në flagrancë.

Si provë materiale hetuesit policorë kanë sekuestruar 375,000.00 (treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) euro, bankënota nga 100 euro dhe 50 euro, si dhe 6 (gjashtë) telefona celularë të personave të dyshuar, për procedura të mëtejme.

### **Emigrantë ilegalë, të fshehur në një kamion që transportonte mallra (lodra fëmijësh), ndalohen në pikëkalimin kufitar**

Policia e Kosovës, konkretisht Policia Kufitare, me datën 30.03.2021 gjatë realizimit të detyrave zyrtare në funksion

të implementimit të planit operativ "Parandalimi i hyrjes së emigrantëve ilegalë dhe kontrabandimi me mallra" rreth orës 10:40 në hyrje të Republikës së Kosovës në terminalin doganor Hani i Elezit, ndaluan kamionin e tipit "Renault", ngjyrë e zezë me rimorkio, të cilin e ngiste vozitësi mashkull/shqiptar, i cili transportonte mallra nga një shtet tjetër.

Kamioni është kontrolluar nga zyrtarët policorë me pajisjen 'Human presence detector' (Zbuluesi i pranisë së njerëzve në automjete) dhe gjatë kontrollit pajisja në fjalë ka dhënë shenja (sinjale) se në rimorkio mund të ketë prezencë të qenieve njerëzore. Pas pranimi të sinjalit është vendosur që rimorkio të hapet dhe të kontrollohet. Në hapjen e kamionit kanë marrë pjesë dy zyrtarë policorë dhe një zyrtar doganor.

Pasi është hapur mbuluesi i rimorkios është vënë re se aty gjendeshin tre (3) persona (emigrantë ilegalë), të fshehur në lodra fëmijësh (mall i ngarkuar në rimorkio).

Emigrantët janë zbritur nga rimorkio për t'u identifikuar dhe për t'u kontrolluar, ndërsa kamioni është dërguar në hangar të terminalit për t'u kontrolluar më në detaje.



### **Prokuroria dhe Policia, në aksion kundër kontrabandës me armë, shtatë (7) persona të dyshuar nën pranga, gjendet sasi e madhe armatimi**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, pas një pune të gjatë hetimore, nën

përdorimin e masave të fshehta teknike, ka realizuar operacionin e përbashkët policor "Stuhia" për parandalimin e veprimtarive të ndryshme kriminale, përfshirë "Kontrabandimin me armë" dhe veprimtari të tjera kriminale, me ç'rast ka arrestuar shtatë (7) persona të dyshuar dhe të njëjtit me urdhër të prokurorit të Shtetit janë ndaluar në kohëzgjatje prej 48 orësh.

Operacioni policor ka filluar në orët e hershme të mëngjesit dhe ka përfshirë tri rajone të Kosovës me gjithsej 13 lokacione të ndryshme, prej tyre: Ferizaj (7) lokacione, Gjilan (2) lokacione dhe Prishtinë (4) lokacione.

Policia gjatë këtij operacioni të gjerë policor ka angazhuar rreth 230 zyrtarë policorë të profileve të ndryshme, të cilët kanë qenë të angazhuar edhe në kontrollin dhe bastisjen e lokacioneve të dyshuara, ku në cilësi të provave materiale kanë sekuestruar:

- 3 granatahedhës dore (tromblon),
- 6 mbushës granatahedhësi (tromblon),
- 1 granatahedhës dore (zollë),
- 2 armë të gjata AK-47,
- 1 armë gjuetie,
- 6 armë e shkurtër - 100 municion,
- Arka me municion të kalibrit 7.62 mm,
- 5 arka të mëdha me fishekë (AK-47)- 8250,
- 12 Arka të vogla me fishekë (AK-47) 180,
- 8 karikatorë (4 të mbushur) - 120,
- Total 8550
- 1 mjet për pastrimin e armëve,
- Pjesë të pushkëve - disa kondakë,
- 1 palë dylbi,
- 4 automjete,
- 1 telefon,
- 2 laptop,
- 2 USB,
- 1 shufër dhe
- 1 palë pranga.

# STRUKTURA TRIKOTOMIALE DHE PROFILIZIMI I POLICIA

Përgatiti:

**Mergim BEKTESHI**

(ZYRTAR POLICOR)

Përgjatë zhvillimeve historike, kriminalistika ka detajuar procese të avancuara me metodat dhe format e saja zhvillimore, duke e bërë më të lehtë kryerjen e veprimeve hetimore për hetuesit policorë, ndjekjet penale për prokurorët dhe një punë më të lehtë për gjyqtarët, për të peshuar provat materiale. Njohësit e kriminalistikës kanë potencuar se juristi penalist (Korajlić dhe Muharremi, 2009) duhet të ketë njohuri të bollshme me shkencën e kriminalistikës për të pasur më të lehtë përballjen, duke parë shkallën e avancuar të krimit e cila ka një trajektore që shfaq pengesë në hapin fillestar për të gjithë ata që ndeshen me luftimin e kësaj dukurie, sidomos Policia dhe Prokuroria.

Në strukturën trikotome të kriminalistikës hyn taktika kriminalistike, teknika kriminalistike dhe metodika kriminalistike, të cilat paraqesin bazën themeltare për një pasqyrë më të detajuar nga vendi i ngjarjes apo skena e krimit, siç quhet në përfundim. Mungesa e kësaj trikotome dyzon preferencën për të siguruar provat materiale apo siç thotë Saferstein linjat e historive që përshkruajnë aftësitë e zgjidhjes së krimit të shkencëtarëve (Saferstein, 2007), më konkretisht kur mungon koherenca në këto linja zbeh

performanca për të drejtën dhe zgjidhja e mozaikut kriminalistik. Metodatat e kriminalistikës janë një avancim drejt luftimit dhe parandalimit të krimit, i cili e bën shoqërinë më të pasigurt përballë normave dhe rendit juridik.

Profesor Vesel Latifi ka theksuar: “Hetuesi është zëri i viktimës” (Latifi dhe Demolli, 2019), në këtë referencë hyn përgatitja profesionale dhe shpresa e viktimës për t’u mbështetur jo vetëm tek institucionet tjera të drejtësisë si Prokuroria dhe Gjykata por edhe tek Policia. Policia në rrugëtimin e saj, ashtu sikur edhe institucionet tjera me karakter penalo-juridik, duhet të fokusohen në metodat operative që mbulojnë pjesën më të madhe të punës në luftën ndaj krimit dhe krimit të organizuar. Kur flasim për krimin e organizuar jo vetëm si nocion, përbën një strukturë homogjene dhe pengesë të rendit juridik, i ndërtuar për të sfiduar shtetin e së drejtës. Pa trikotomën kriminalistike as që bëhet fjalë luftimi dhe parandalimi i krimit të organizuar. Taktika, teknika dhe metodika së bashku përbëjnë strumbullarin e punëve kriminalistike, e para studion format dhe manifestimet e veprave penale, mënyra e kryerjes së veprës dhe qëllimet e kryesit që stigmatizohet pastaj me fenomenologjinë kriminale dhe psikologjinë. Teknika përfshin shkathtësitë e larta profesionale, ndër ato edhe komunikimin, grumbullimin dhe specifikimin e informatave

por edhe një varg më të gjerë të shfrytëzimit të mjeteve shkencore, të cilat në shekullin që po jetojmë kanë një përparim të lartë. Kriminaliteti është dukuri negative shumë komplekse dhe dinamike që u përshtatet ndryshimeve shoqërore (Korajlić dhe Muharremi, 2009) krahas kësaj metodika përcakton një gërshetim në mes të teknikës dhe taktikës kriminalistike, një sfidë, duke parë metodat e ndryshme të kryerjes së veprave penale nga kryesi.

Policia bashkëkohore por edhe ajo e Kosovës në misionin e saj “është parandalimi i kriminalitetit, zbulimi dhe hetimi i kryerësve të veprave penale, me anë të mbledhjes dhe paraqitjes së fakteve, dëshmive dhe provave, që dëshmojnë fajësinë ose pafajësinë e personave të dyshuar për vepra penale, si dhe vënja e kryerësve të veprave penale para drejtësisë” (PK). Ky përshkrim i detyrave dhe misionit të saj paraqet strukturën trikotome që arrihet përmes punës operative dhe mbështetur në këtë departament, që përmes veprimtarisë preventive dhe represive të parandalojë veprimtarinë kriminale.

Fusha dhe zbatimi i metodave kriminalistike paraqet një ekuivalencë që do trajtim të lartë profesional nga ana e hetimeve, po ashtu edhe prokurorë që të kenë njohuri të detajuara në kriminalistikën si shkencë. Kur flasim për trikotomen është e rëndësishme se



# ME E KRIMINALISTIKËS CISË NË KËTË SEGMENT

**Në strukturën trikotome të kriminalistikës hyn taktika kriminalistike, teknika kriminalistike dhe metodika kriminalistike, të cilat paraqesin bazën themeltare për një pasqyrë më të detajuar nga vendi i ngjarjes apo skena e krimi, siç quhet në perëndim**

si t'iu qasemi edhe provave materiale dhe jo materiale. Agjencia e Kosovës për Forenzikë, si institucion i pavarur nga Policia, vepron me profesionalizëm (AKF, 2021) duke bërë ekzaminimet e provave materiale në disa sektorë të saj, ka një kontribut të veçantë në trikotomen. Njohësit e procedurës penale e kanë duartrokitur kriminalistikën si shkencë. Sipas tyre: "Shpeshherë nuk dihet se a është fjala për vetëvrasje të ftinguar, (kurdisur), për vrasje ose vetëvrasje të vërtetë, se a është fjala për dokumentin e falsifikuar apo dokumentin origjinal (Sahiti dhe Murati, 2016), të gjitha këto dilema i sqaron kriminalistika në sallën e gjyqit që kërkohen me ngulm nga palët në procedurë.

Gjykatat tanimë kanë ngritur kriteret për paraqitjen e provave nga palët në procedurë dhe vetëm ato prova të cilat



manifestohen në rrjedhën profesionale arrijnë të fajësojnë dhe shfajësojnë palët në procedurë apo postulati romak da mihi factum, dabo tibi ius (më jep fakte të jap të drejtën), larg nga koha e mesjetës ku fajësia manifestohej me një provë të vetme. Në këtë proces rol të rëndësishëm kanë organet e rendit, Policia, ku barra e përgjegjësisë në terren bije mbi hetues, për të siguruar provat në bazë të procedurës penale (KPPRK), më saktë nga neni 69 i këtij kodi. Një varg çështjesh lidhen me trikotomen kriminalistike, që nga marrja e informatës për kryerjen e veprës penale apo përgatitja e veprës penale. Si për të parën edhe për të dytën krahas instinktit apo nuhatjes së thelluar duhet njohja me shkencën

kriminalistike, vetëm në këtë mënyrë krijohet një transparencë gjithëpërfshirje për argumentimin e provave materiale me efekt penalo-juridik.

#### *Bibliography*

- Korajlić dhe Muharremi . (2009). *Kriminalistika*. Prishtinë: Rinvest.
- AKF, A. K. (2021). Agjencia Kosovare për Forenzik. Retrieved from Agjencia Kosovare për Forenzik: <https://akf.rks-gov.net/Departments.aspx>
- Kosovës, P. e. (n.d.). Departamenti i Hetimeve. Retrieved from Policia e Kosovës: <https://www.kosovopolice.com/departamentet/departamenti-i-hetimeve/>
- KPPRK. (n.d.). KODIN E PROCEDURES PENALE. Retrieved from KODIN E PROCEDURES PENALE: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>
- Latifi dhe Demolli. (2019). *Kriminalistika*. Prishtinë: Universiteti Prishtinës.
- PK. (n.d.). Departamenti i Hetimeve. Retrieved from Policia e Kosovës: <https://www.kosovopolice.com/departamentet/departamenti-i-hetimeve/>
- Saferstein, R. (2007). *Criminalistics*. New Jersey: Pears Education Inc.
- Sahiti dhe Murati. (2016). *E drejta e procedurës penale*. Prishtinë: Botime Artini.

# KURIOZITETE

## 16 fakte interesante që nuk i dini për vende të ndryshme të botës

### Franca

Franca mban titullin e mbulimit të plotë 12 zonave kohore. Në të njëjtën kohë zona të ndryshme shënojnë orë të ndryshme.

### Maldivë

Me gjithë bisedimet rreth ngrohjes globale dhe rritjes së nivelit të detit, banorët e Maldivëve kanë arsye për t'u frikësuar. Me një lartësi mesatare rreth 1.8 metra mbi nivelin e detit, shteti i tyre është më i ulëti në tokë.

### Nauru

Mbi 95 për qind e popullsisë mbipeshë, ishulli i Naurusë është vendi më i shëndoshë në botë. Epidemia e obezitetit të këtij vendi kryesisht i atribuohet importimit të ushqimit të shpejtë perëndimor që përkoi me rritjen e standardit të jetesës në shekullin e 20-të.

### Guam

Për shkak se Guam nuk ka rërë natyrore por korale, njerëzit e këtij ishulli e shtruan asfaltin me përzierjen e koraleve tokësore dhe naftës, në vend të importimit të rërës nga jashtë.

### Ishujt Falkland

Vetëm 3,000 njerëz kanë mesatarisht gjysmë milion dele, që do të thotë mesatarisht 350 dele për person. Ndaj dhe ky vend njihet për eksportin e madh të leshit.

VIJON NË NUMRIN E RADHËS

## Disa kuriozitete të çuditshme, por ia vlen t'i lexoni



*Lista e habive të mëposhtme do t'ju ndihmojë të vijoni me sukses zakonet tuaj të dashur, atë të rrëfimit të kuriozitetëve më interesante në botë:*

*A e dini që pas moshës tridhjetë vjeç njerëzit shkurtohen 1 cm çdo 10 vjet?!*

*Lotët që derdhim për arsye të ndryshme (p.sh. nga gëzimi, hidhërimi, qërimi i qepëve etj.) kanë përbërje të ndryshme.*

Gjatë muajve të shtatzënisë truri i grave zvogëlohet ndjeshëm, vetëm gjashtë muaj pas lindjes rikthehet në gjendjen e tij të mëparshme.

A e dini që kur skuqemi e njëjta gjë ndodh dhe në stomakun tonë?

Pas moshës 60 vjeç njerëzit humbasin gjysmën e sensit të shijes.

Në gojën tonë jetojnë më shumë bakterie se sa e gjithë popullsia e tokës.

Në trupin tonë kemi dhjetë herë më shumë bakterie se sa qeliza.

Në qoftë se do të shtjellonim të gjitha enët e gjakut (venat, arteriet, kapilarët) nga njëra anë në tjetër, do të mund të rrethonin me to së paku dy herë të gjithë Tokën.

Midhjet mund të ndryshojnë disa herë gjini përgjatë gjithë jetës së tyre.

Gjarpërinjtë fluturues mund të përshkojnë një distancë prej 100 m në ajër.

Gjuha e balenës blu peshon sa një elefant i rritur.

Peshkaqenët e bardhë e të mëdhenj mund të identifikojnë rënien e një pike gjaku në 100 litra ujë, gjithashtu mund të zbulojnë sasi të vogla gjaku në një distancë prej 5 km.

Dhëmbët e kastorit nuk ndalojnë së rrituri asnjëherë, brejtja e drurëve e ndihmon që t'i ruajë në madhësinë e duhur.

Shtatzënia e elefantëve të Afrikës zgjat plot dy vjet.

Gjuha e kamelonit mund të jetë aq e gjatë sa dhe etrupi i tij.

## Pronari, që ju vodh Mercedesi, i fton hajnat për kafe



Biznesmeni nga Mitrovica përmes një postimi ka treguar se si është vjedhur vetura e tij të cilën pas një jave e ka gjetur. Qytetari, B. U., ka falënderuar Policinë e Kosovës së bashku me Njësinë e Auto-Krimeve në Prishtinë, të cilët kanë ndihmuar në gjetjen e veturës. Mitrovicasi gjithashtu ka ftuar për kafe personat të cilët ia vodhën veturën.



## Shoferi i kamionit bëri një manovër të gabuar dhe përfundoi në çatinë e një garazhi në Itali



Në Palermo, Itali, një shofer kamioni bëri një manovër të gabuar me një kamion dhe përfundoi në çatinë e një garazhi.

Ai po qëndronte pezull në ajër dhe banorët e një ndërtese aty pranë u evakuuan për shkak të rrezikut të rënies së një kamioni.

Ndërhyrja e zjarrfikësve siguroi vendin e ngjarjes dhe automjeti u kthye në rrugë, kurse njerëzit u kthyen në shtëpitë e tyre.

## Mijëra njerëz mbledhen për koncertin që kishte nisur si gënjeshtëri e 1 prillit

Policia në Belgjikë ka përdorur gaz lotsjellës dhe ujë për të shpërndarë një turmë të njerëzve të cilët ishin mbledhur për një koncert të rremë që ishte publikuar në rrjetet sociale si një shaka në ditën e gënjeshtreve.

Rreth 2,000 njerëz ishin në ngjarjen në parkun Bois de la Cambre të Brukselit, duke thyer rregullat për COVID-19.

Kur policia arriti, disa në këmbë e disa

mbi kuaj, nga turma u dëgjua britmat "Liri!" dhe gjuajtën predha.

Policia ka thënë se katër njerëz janë arrestuar.

Tre policë janë lënduar gjatë përlëshjeve, ndërsa raportohet se edhe dy njerëz kanë pësuar lëndime.

Njoftimi për koncertin u bë në mars në Facebook, me paralajmërimin se një DJ i famshëm do të ishte i pranishëm.

## Përse piloti dhe kopiloti kurrë nuk hanë të njëjtin ushqim?

Siguria e udhëtarëve në aeroplan pothuajse është tërësisht në duar të personelit, kështu që piloti në fluturimet komerciale duhet patjetër të respektojë edhe gjëra të caktuara.

Megjithatë, disa rregulla asses nuk bën të shkelen, ku njëra ndër to është që piloti dhe kopiloti, piloti tjetër apo i dytë nuk bën të hanë të njëjtin ushqim.

Edhe pse, sipas rregullit, mund të duket e çuditshme, për këtë ekzistojnë arsye shumë të mira, natyrisht ato janë të natyrës së sigurisë. Për shembull, nëse diçka shkon keq me racionin e njërit pilot dhe ai helmohet me ushqim, piloti tjetër nuk do ta ketë të njëjtin fat dhe do të jetë në gjendje të marrë drejtimin e aeroplanit.

Është me rëndësi të thuhet edhe që kjo praktikë nuk është e paraparë me

ligj, mirëpo është paraparë në rregullat të cilat i caktojnë vetë kompanitë e aviacionit, në mënyrë që sa më mirë t'i mbrojnë udhëtarët e tyre, transmeton telegrafi.

Gjithashtu, pilotëve u jepen këshilla edhe për shmangie të ushqimit të caktuar para fluturimit, siç janë peshqit e papërpunuar.

Helmimi me ushqim në fluturime është i rrallë, mirëpo janë shënuar disa raste.

Rasti më i njohur është ai i vitit 1982, kur me pudingun e prishur janë helmuar madje dhjetë anëtarë të ekuipazhit duke përfshirë edhe pilotin dhe kopilotin.

Megjithatë, madje edhe atëherë, pilotët kanë arritur ta kthejnë aeroplanin në Boston.

# Info.

## Numrat e Stacioneve Policore

### Rajoni i Prishtinës

|                               |            |
|-------------------------------|------------|
| Drejtoria Regionale Prishtinë | 038540021  |
| Trafiku Rajonal Prishtinë     | 038534234  |
| Stacioni Policor Obiliq       | 038561600  |
| Stacioni Policor Fushë Kosova | 038535812  |
| Stacioni Policor Graçanica    | 038564292  |
| Stacioni Policor Lipjan       | 038581010  |
| Stacioni Policor Drenas       | 038/584092 |
| Stacioni Policor Podujevë     | 038571805  |
| Stacioni Policor Veriu        | 038249942  |
| Stacioni Policor Jugu         | 038549924  |
| Stacioni Policor Qendra       | 038502223  |
| N/Stacioni Policor Orllan     | 038614972  |
| N/Stacioni Policor Bernicë    | 038515092  |
| N/Stacioni Policor Magure     | 038502472  |
| Nenstacioni Policor Janjevë   | 038567009  |

### Rajoni Peja dhe Gjakova

|                                 |                 |
|---------------------------------|-----------------|
| Drejtoria Regionale Pejë        | 039 432327      |
| Drejtoria Regionale Gjakovë     | 038 504504-5510 |
| Stacioni Policor Pejë           | 039 433273      |
| Trafiku Rajonal Gjakovë         | 0390 323784     |
| Trafiku Rajonal Pejë            | 039 432595      |
| Stacioni Policor Gjakovë        | 0390 322482     |
| Stacioni Policor Istog          | 039 451374      |
| Stacioni Policor Klinë          | 039 471199      |
| Stacioni Policor Deçan          | 0390 361020     |
| Stacioni Policor Rahovec        | 029 277913      |
| Stacioni Policor Malishevë      | 038 269007      |
| Nën Stacioni Policor Gorazhdevc | 039 467389      |
| Nën Stacioni Policor Junik      | 0390 370092     |
| Nën Stacioni Policor Vitomiricë | 039/442 203     |
| Nën Stacioni Policor Ponashevc  | 0390 370888     |

### Rajoni i Mitrovicës

|                                          |             |
|------------------------------------------|-------------|
| Drejtoria Regionale Mitrovicë            | 028/532 366 |
| Njesia e Trafikut Rajonal Mitrovicë      | 028 532 628 |
| Stacioni Policor Mitrovicë Jugu          | 028 532 585 |
| Stacioni Policor Skenderaj               | 028/582 087 |
| Stacioni Policor Vushtri                 | 028/572 010 |
| Stacioni Policor Zubin Potok             | 028 461 042 |
| Stacioni Policor Zveçan                  | 028 665 130 |
| Stacioni Policor/Regjioni Mitrovicë Veri | 028 425 170 |
| Stacioni Policor Leposaviq               | 028/83 424  |
| Nën Stacioni Policor Prilluzhe           | 028 573 509 |

### Rajoni i Prizrenit

|                               |             |
|-------------------------------|-------------|
| Drejtoria Regionale Prizren   | 029/244 355 |
| Trafiku Regional Prizren      | 029/244 655 |
| Stacioni Policor Suharekë     | 029/271 024 |
| Stacioni Policor Dragash      | 029/281 017 |
| Nënstacioni Policor Sredskë   | 038/502 575 |
| Nënstacioni Policor Mushtisht | 029/275 105 |
| Nënstacioni Policor Mamushë   | 029/273 453 |
| Nënstacioni Policor Zhur      | 029/625 092 |

### Rajoni i Gjiçanit

|                               |                 |
|-------------------------------|-----------------|
| Drejtoria Regionale Gjiçan    | 0280/330 188    |
| Stacioni Policor Gjiçan       | 0280/330 061    |
| Trafiku Regional Gjiçan       | 0280/330 091    |
| Stacioni Policor Novobarda    | 038/576 092     |
| Stacioni Policor Viti         | 0280/381 513    |
| Stacioni Policor Kamenica     | 0280/372 390    |
| Nënstacioni Policor Kllokot   | 0280/381 094    |
| Nënstacioni Policor Ranillug  | 038/504504-7878 |
| Nënstacioni Policor Zheger    | 0280/386 011    |
| Nënstacioni Policor Pozharan  | 0280/386-269    |
| Nënstacioni Policor Muqiverrc | 0280/ 320 197   |

### Rajoni i Ferizajit

|                                |               |
|--------------------------------|---------------|
| Drejtoria Regionale Ferizaj    | 0290/ 322 406 |
| Stacioni Policor Ferizaj       | 0290/ 327 412 |
| Trafiku Regional Ferizaj       | 0290/ 321 899 |
| Stacioni Policor Shtërpçë      | 0290/ 70092   |
| Stacioni Policor Kaçanik       | 0290/380 834  |
| Stacioni Policor Hani i Elezit | 0290/385 015  |
| Stacioni Policor Shtime        | 0290/389 008  |

Përgatiti: Çajup KAJTAZI



# Duke nderuar zyrtarët tanë

PUNONJËSIT E POLICISË SË KOSOVËS QË KANË HUMBUR JETËN NGA 'COVID 19'



**ILIR GJOKA**  
18.01.1981-16.07.2020



**BOJAN RISTOVIC**  
10.09.1971-29.07.2020



**LIJBICA JANICEVIC**  
05.02.1983-07.08.2020



**MALIO HOTI**  
14.06.1968-12.08.2020



**GEGË PRENAJ**  
09.05.1958-12.08.2020



**HAKIF HODOLLI**  
01.05.1956-19.08.2020



**MIFTAR KURTI**  
29.03.1964-21.08.2020



**HYSNI JERLIU**  
10.08.1965-25.08.2020



**ALI QELAJ**  
27.04.1971-27.08.2020



**EMRUSH KLOKOCI**  
24.06.1959-03.11.2020



**SOKOL MAXHARRAJ**  
22.04.1956-19.11.2020



**SRDJAN SPASOJEVIC**  
24.09.1968-20.11.2020



**ISMET OSMANI**  
12.01.1969-16.12.2020



**HAJRUSH GASHI**  
11.08.1960-24.01.2021



**DUGAGJIN MEHMETI**  
02.02.1969-17.02.2021



**PETAR MILENKOVIC**  
15.07.1979-04.03.2021



**HEKREM HALITI**  
16.04.1970-22.03.2021



**FATMIR KRASNIQI**  
04.06.1969-30.03.2021



**LULËZIM KRASNIQI**  
11.01.1976 - 02.04.2021



**PETRIT HAXHIU**  
29.11.1963 - 09.04.2021



**SELVER MALICI**  
30.03.1970 - 14.04.2021



**BEKIM.T. KRASNIQI**  
11.10.1970 - 08.05.2021